



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-086

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut 2004/49 PER
VEPRIMTARITË E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËSIT,
KANALIZIMIT DHE TË MBETURINAVE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjiellit, Kanalizimit dhe Mbeturinave ("Rregullorja")

Duke marrë parasysh nevojën për të ndryshuar Rregulloren në mënyrë që arrihet pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentët tjerë relevantë,

Miratton këtë

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut 2004/49 PER
VEPRIMTARITË E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËSIT,
KANALIZIMIT DHE TË MBETURINAVE**

Neni 1

Secilën herë që përmendet "Rregullorja" në Rregullore, ajo do të zëvendësohet me fjalën "Ligji". Pas çdo përmendje të "AKM-së" në Rregullore, do të shtohen fjalët "institucioni pasardhës".

Neni 2

Teksti i tërë pjesës hyrëse të Rregullores të zëvendësohet me formulimin në vijim:

"Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të autoritetit të dhënë me nenin 65, 119.5 dhe 142 të Kushtetutës,

Duke e njohur nevojën për të përmirësuar sektorët e shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave në Kosovë përmes themelimit të një rregullatori të pavarur përgjegjës për rregullimin e këtyre sektorëve në Kosovë,

Me anë të kësaj miraton si vijon:

LIGJ PËR VEPRIMTARITË E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËSIT, KANALIZIMIT DHE TË MBETURINAVE

Neni 3

Neni 1.2 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenet 1.2 dhe 1.3 në vijim:

1.2 Me anë të kësaj themelohet Zyra rregullative e ujësjellësit dhe e mbeturinave (në tekstin e mëtejshëm “Rregullatori”) si një organ i pavarur në pajtim me nenin 119.5 dhe 142 të Kushtetutës.

1.3 Rregullatori e ka drejtorin, zëvendësdrejtorin e kuadrin profesional dhe nëpunësit. Drejtori dhe zëvendësdrejtori emërohen nga Kuvendi i Kosovës pas rekomandimit të Qeverisë për një afat pesë (5) vjeçar.

Drejtori dhe Zëvendës Drejtori duhet të kenë kualifikimet e duhura profesionale dhe integritetin më të lartë.

Drejtori dhe Zëvendësdrejtori, secili mund t’i propozojë kuvendit shkarkimin nga puna të tjetrit për paaftësisë profesionale apo sjellje të pahijshme. Baza për shkarkimin apo dorëheqjen e detyrueshme të secilit prej tyre përfshin, por nuk kufizohet me:

- a) vdekjen;
- b) paaftësinë mendore apo fizike;
- c) diskualifikimin sipas dispozitave të këtij ligji;
- d) deklarinimin e falimentit apo paaftësisë paguese;
- e) mungesën e paarsyetuare nga tre mbledhje konsekuative dhe te rregullta të Rregullatorit;
- f) dënimin për kryerjen e një vepre penale;
- g) interesat e drejtpërdrejta personale, martesore apo familjare në një licencë të dhënë sipas dispozitave të këtij Ligji; apo
- h) përfitimet financiare të marra nga bizneset e rregulluara me këtë Ligj;

1.4 Drejtori dhe Zëvendësdrejtori, secili mund të japë dorëheqjen nga Rregullatori, nëse jep njoftim me shkrim të paktën tre (3) muaj para.

Neni 4

Neni 1.3 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 1.4 në vijim:

1.4 Rregullatori është përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve në pronësi shoqërore dhe publike të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë. Rregullatori merr vendime të pavarura gjatë ushtrimit të përgjegjësive në bazë dispozitave të këtij Ligji ose çfarëdo rregulloreje ose ligji në fuqi dhe çfarëdo urdhërese administrative, udhëzimi administrativ ose vendimi tjetër i cili mund të nxirret në vijim.

Neni 5

Në nenin 2, paragrafi i titulluar "Komuna" të zëvendësohet në tërësi me formulimin në vijim:

“Komunë” do të ketë kuptimin e përkufizuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale ;

Neni 6

Neni 8.4 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 8.4 në vijim:

8.4 Rregullatori, pas konsultimeve me Kuvendin dhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave nxjerr udhëzime administrative me anë të të cilave e cakton lartësinë e taksave që duhet të paguhet në pajtim me këtë nen apo metodën e llogaritjes së këtyre taksave.

Neni 7

Në nenin 21.4 (ii) të Rregullores, të fshihet shprehja "përfaqësuesit rajonal të Shtyllës II të UNMIK-ut, AKM dhe."

Neni 8

Në nenin 34.2 të Rregullores, shprehja "Zëvendëspërfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për rindërtim dhe zhvillim ekonomik" të zëvendësohet me fjalën "Kuvendi"

Neni 9

Neni 40 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 40 në vijim:

"Ky Ligj hyn në fuqi pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 10

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-086
13 qershor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI